

**Ceremonia e inaugurimit të Sheshit të Lojërave për Fëmijët e Verbër, Instituti i Fëmijëve që  
nuk shikojnë “Ramazan Kabashi” (Tiranë)**

**18 prill 2013**

**Fjala e Kryetarit të Prezencës  
(KONTROLLO KUNDREJT FJALËS SË MBAJTUR)**

Z. Xhaferri,  
Mësues, fëmijë dhe prindër,

Mirëdita!

E kam pritur me shumë kënaqësi këtë ditë.

Projektin që mbyllim sot me këtë ceremoni e kam shumë për zemër, jo vetëm unë, por i gjithë ekipi i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Ky projekt u ofron këtyre fëmijëve një vend të përshtatshëm dhe të sigurt lojërash. Është e drejta e tyre të kenë një vend për të luajtur, si çdo fëmijë tjetër.

Për këtë arsye, është një kënaqësi e madhe për të gjithë ne që të shohim rezultatet e punës sonë dhe të mendojmë se kemi dhënë një lloj kontributi në mirëqenien e tyre, dhe le të shpresojmë, edhe në lumturinë e tyre.

Por ky kontribut praktik nuk është një aktivitet i izoluar.

Ai në fakt ofrohet në kuadrin e mbështetjes së vazhdueshme të Prezencës së OSBE-së, në përputhje me mandatin tonë për përfshirjen sociale dhe politike të grupeve në nevojë, si romët, minoritete të tjera dhe, sigurisht, edhe personat me aftësi të kufizuara.

Kështu, për shembull, kemi mbështetur hartimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara, si dhe ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuara. Jam i lumtur që kemi këtu sot një përfaqësues të Shoqatës Kombëtare Shqiptare të të Verbërve.

Ngritja e Forumit të të Rinjve me Aftësi të Kufizuara është një tjetër nismë me vlerë, që kemi mbështetur, së bashku me partnerët tanë, Këshilli Britanik dhe Fondacioni Vodafone.

Megjithatë, shumë më tepër mund të bëhet për t'i përfshirë personat me aftësi të kufizuara në procesin vendimmarrës, si dhe për t'i integruar ata më mirë në shoqërinë shqiptare.

Është në të mirën e së ardhmes së këtij vendi që të drejtat e njeriut të të gjithëve të respektohen dhe të promovohen, pa diskriminim.

Kjo është një e drejtë themelore dhe një domosdoshmëri për demokracinë.

Mjerisht, e vërteta është që në Shqipëri, personat me aftësi të kufizuara përballen me sfida të panumërta në jetën e tyre të përditshme, qoftë sa i përket mundësive për arsimim, kujdes shëndetësor, punësim, apo pjesëmarrjes në jetën publike dhe kulturore.

Institucionet demokratike nuk mund të rrinë mënjane. Ato duhet të angazhohen aktivisht për të hequr pengesat që nuk i lënë qytetarët të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre të njeriut dhe të japin kontributin e tyre në shoqëri.

Dhe ky kontribut, ndoshta i vogël, por gjithsesi me vend – një kënd lojërash për 60 fëmijë që nuk shikojnë, të cilët mësojnë dhe jetojnë në këtë Institut – tregon se çfarë mund të arrihet me burime relativisht modeste.

Ai jep, gjithashtu, edhe idenë se çfarë mund të arrihet kur ka përkushtim për njerëzit e për të zgjidhur problemet sociale.

I nderuar z. Xhaferri,  
Miq,

Më lejoni ta mbyll fjalën time duke përgëzuar punën e Institutit të Fëmijëve “Ramazan Kabashi”, i vetmi institut publik, që u ofron shërbime të tilla fëmijëve që nuk shikojnë në Shqipëri.

Puna e tij është vërtet për t’u vlerësuar. Një shërbim publik real dhe i përkushtuar: një shembull që mund dhe duhet ndjekur.

Fëmijë, shpresoj që të gjithë të kënaqeni duke luajtur në këtë kënd lojërash. Dhe shpresoj sinqerisht që, kur të rriteni, të keni të njëjtat mundësi si kushdo tjetër në këtë vend.

Faleminderit!